

# **RREGULLAT SPECIFIKE PËR TREGTIMIN E ZONAVE TË IMPORTIT DHE EKSPORTIT**

**Rregullat e Tregut – Shtojca 6**

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike

## **1. Hyrje**

- 1.1. Këto rregulla janë pjesë e Rregullave të Tregut dhe përmbajnë dispozita të hollësishme në llogaritjen e ofertave dhe çmimeve në zonat e eksportit dhe në zonat e importit.
- 1.2. OST, siguron një sasi të caktuar të kapacitetit transmetues disponibël të ditës në avancë për zonat e importit dhe eksportit. Këto kapacitete janë të publikuara në faqen zyrtare të Bursës Shqiptare të Energjisë deri në orën 10.00 të çdo dite në Ditët e Tregtimit.
- 1.3. Pjesëmarrësit të cilët kanë hyrë në marrëveshje përkatëse me OST-në, janë të lejuar të hapin portofolin për tregtim në një ose me shumë, në zonat e importit dhe eksportit.

## **2. Kufizime të veçanta në ankandet për eksport ose import në zonat e veçanta.**

- 2.1. Vetëm aplikimet orare janë të lejueshme për ofertim në zonat e importit dhe eksportit.
- 2.2. Në zonat e Eksportit janë të lejueshme vetëm porositë për blerje.
- 2.3. Në zonat e Importit janë të lejueshme vetëm porositë për shitje.
- 2.4. Vëllimet e ofertave për Anëtar në çdo orë nuk duhet ta tejkalojë kapacitetin tregtar disponibël në lidhjet përkatëse, për orët përkatëse.

## **3. Llogaritja e çmimit dhe e sasive**

- 3.1. Në zonat e importit, çdo sasi e shitur e Anëtarëve llogaritet bazuar në aplikimet e shitjes së Anëtarëve sipas ekuilibrit ndërmjet kurbës së shitjes të zonës së importit dhe sasisë së llogaritur të importit.
- 3.2. Nëse sasia totale e shitjes me çmimin minimal nga të gjithë Anëtarët në zonat e importit tejkalon kapacitetin disponibël në drejtim të Shqipërisë, sasia e shitur për çdo Anëtar do të kufizohet proporcionalisht deri në arritjen e çmimit minimal.

- 3.3. Në zonat e eksportit sasia e blerjes së çdo Anëtari do të llogaritet bazuar në aplikimin e blerjes së çdo Anëtari sipas ekuilibrit ndërmjet kurbës së blerjes të zonës së importit dhe sasisë së llogaritur të eksportit.
- 3.4. Nëse sasia totale e blerjes me çmimin maksimal nga të gjithë Anëtarët në zonat e eksportit tejkalon kapacitetin disponibël në drejtim të Shqipërisë, sasia e blerë për çdo Anëtar do të kufizohet proporcionalisht deri në arritjen e çmimit maksimal.
- 3.5. Sasitë e blera në zonat e eksportit ose të shitura në zonat e importit do të zgjidhen gjithmonë në Zonën Shqiptare të Çmimit.